

SHKOLLA PËR POLITIKA për vitin 2022

Pyetje të parashtruara shpesh:

- 1. Kur dhe në çfarë formati do të organizohen modulet e Shkollës për politika?**
- Shkolla për politika do të organizohet në 5 module edukative, në kohëzgjatje prej 5 fundjavësh. Çdo modul do të zgjasë sa një fundjavë. Fundjavët, përkatësisht modulet nuk do të jenë një pas një. Moduli do zgjasë nga e premtja në orët e pasdites deri të dielën në orët e pasdites. Moduli i parë është parashikuar të mbahet nga 25-27 mars 2022. Duke pasur parasysh masat dhe protokollet për punë në kohë pandemie me virusin kovid-19 ekziston mundësia disa module të mbahen onlajn, edhe pse QPEP-ja do të këmbëngulë që modulet të mbahen drejtpërdrejt, në qytete të ndryshme në shtet për shkak të imapktit të Shkollës për politika.
- 2. Në cilat gjuhë duhet të dërgohen dokumentet e nevojshme për aplikim në Shkollën për politika?**
- Dokumentet për aplikim mund t'i dërgoni në një nga gjuhët e punës të Shkollës për politika - maqedonisht, shqip ose anglisht, sipas përzgjedhjes së aplikuesit.
- 3. A duhet të dërgohen aplikimet edhe me postë?**
- Jo, aplikimet duhet të dërgohen vetëm në postën elektronike:
l.matevska@president.mk.
- 4. A është e nevojshme të shkruhen dy ese? A është eseja e kufizuar se sa fjalë duhet të ketë? Në çfarë formati duhet të dërgohet eseja? A do të jetë eseja e shkruar në gjuhën maqedonase ose në gjuhën shqipe vlefshme?**
- Si pjesë e aplikimit për në Shkollën për politika, nevojitet të shkruhet vetëm 1 ese, për njërën nga dy temat e ofruar, në gjuhën angleze, me përzgjedhje të aplikuesit. Eseja nuk është e kufizuar për numrin e fjalëve dhe mund të dërgohet në formatin Word ose PDF, sipas përzgjedhjes së aplikuesit. Eseja e dorëzuar në gjuhën maqedonase ose gjuhën shqipe nuk do të konsiderohet si dokument valid si pjesë e dokumentacionit të plotësuar për aplikim në Shkollën për politika për vitin 2022.
- 5. A është kufiri i moshës i pjesëmarrësve i pandryshueshëm, a mund të bëhet përjashtim?**
- Kufiri i moshës, si dhe kushtet e tjera për pjesëmarrje në Shkollat për politika janë përcaktuar nga Këshilli i programit i Qendrës Presidenciale për Edukim Politik dhe janë të pandryshueshme.

6. A duhet të jenë të dyja rekomandimet për Shkollën për politika me shkrim apo mund të vendosen vetëm informacionet për kontakt të profesorëve/punëdhënësve/bashkëpunëtorëve nga të cilët jepet rekomandimi?

- Të dyja rekomandimet duhet të dërgohen në formë të gjatë me shkrim, me nënshkrim nga personi i cili e jep rekomandimin.

7. Çfarë fitojnë pjesëmarrësit nga pjesëmarrja në Shkollën për politika?

- Pjesëmarrësit në Shkollën për politika do të fitojnë mundësinë të njihen me përfaqësues me renome nga akademja, jeta politike dhe të bashkësisë së biznesit nga vendi dhe jashtë, me të cilët do të mund të shkëmbejnë përvoja dhe njohuri në shumë fusha të jetës. Nëpërmjetpërforcimit të shkathtësive të tyre komunikuese, lidere dhe shkathtësitë e buta do t'u mundësohet të shkëmbejnë mendime me moshatarët e tyre mbi shumë sfera të jetës politike dhe shoqërore në shtet. Do të kenë mundësi të ndërtojnë miqësi shumëvjeçare dhe kontakte të rëndësishme, duke punuar në grupe dhe në mënyrë individuale në punëtoritë interaktive me profesionistë nga shumë fusha. Në fund, do të mund t'i përparojnë njohuritë e veta që i kanë deri tani, por edhe do të fitojnë shumë njohuri të reja duke përpunuar shumë tema nga politika, e drejta, demokracia, eurointegrimet, bashkëpunimin e jashtëm, marrëdhëniet me publikun, komunikimet, mjedisin jetësor, zhvillimin e qëndrueshëm, mediat e reja e të tjera.

8. Po nëse jam person me aftësi të kufizuara, a mund të marr pjesë në Shkollën për politika?

- Po, sigurisht, pjesëmarrja tënde është e mirëseardhur! Shkolla për Politika e Qendrës Presidenciale për Edukim Politik do të organizohet në mënyrë inkluzive dhe me qasje, e cila do të mundësojë që të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, të marrin pjesë dhe të kontribuojnë tërësisht. Nëse jeni person me aftësi të kufizuara, këtë mund ta vendosësh në formularin për paraqitje, ku mund të theksosh nëse të nevojitet mbështetje për qasje në eveniment (gjuha e shenjave, Alfabeti i Brajtit etj.)